



Historia e djaloshit 20-vjeçar nga fshati Brrut i Malsisë së Madhe, i cili në vitin 1990-të botoi në gazetën "Drita" poezinë e famshme që e detyroi më pas të merrte rrugën e arratisë në drejtim të kufirit shtetëror me Jugosllavinë. Të gjitha peripecitë e arratisjes dhe dëshmia e redaktorit Nasi Lera, që i botoi poezinë: "Të nesërmen më telefonuan nga lart dhe më thanë se çfarë kishim bërë me atë poezi që 'njerëzit tanë' i quante kuaj"

DASHNOR KALOÇI

Ka qenë e diela e fundit e muajit gusht të vitit 1990, kur në një cep të gazetës letrare "Drita", një poezi e fare e shkurtër e titulluar "Kuajt", tërhoqi vëmendjen e lexuesve të shumë dhe bëri një bujë të jashtëzakonshme, aq sa tirazhi i madh i gazetës së njohur u përpi brenda ditës. Po ç'ishte ajo poezi, kush ishte autori i saj e çfarë thuhej aty në ato pak rreshta që njerëzit e shumë filluan ta kopjojnë e ta shpërndajnë fshehurazi me njeri-tjetrin nëpër copa letrash, ndonëse ajo ishte e botuar në shtypin zyrtar? Gjek Marinaj me banim në Richardson të Tekxasit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku jeton që nga viti 1990 kur u arratis nga Shqipëria pas botimit të poezisë së famshme, rrëfen për gazetën "Shqip", gjithëçka nga ajo ngjarje e largët e 16 viteve të shkuara, kur ato pak vargje vunë në përshtjellim deri majën e piramidës së shtetit komunist të asaj kohe, për të ndëshkuar redaksinë e "Dritës" dhe vetë atë autorin rebel që guxonte të shkruante: "Po ishim dhe mbetëm kuaj para njeriut"

Marinaj: Ne flinim pa bukë

Deri ditën që u arratis, në shtatorin e 1990-ës, Gjeka jetonte së bashku me familjen e tij në një fshat të thellë të Malësisë Madhe të quajtur Brrut. Nuk i dihet edhe sa do të qëndronte në atë fshat të largët me ato pak shtëpi, sikur në gushtin e 1990-ës, të mos i ishte botuar ajo poezi që i ndryshoi krejtësisht rrjedhën e jetës tij. Si shumë familje të tjera, edhe Marinajt jetonin në një varfëri të thellë. Lidhur me gjendjen në të cilën ndodhej ajo asokohe, Gjeka kujton: "Babai dhe nëna ime për vetë kushtet që kishin me një arsim minimal, ishin të detyruar që t'i përvisheshin punës fizike për të na rritur ne shtatë fëmijëve, që ishim radhë njeri pas tjetrit. Shtëpia jonë ashtu si të gjitha shtëpitë e Brrutit, ishte krejt e vjetër dhe nga që ishim shumë fëmijë, babai kishte filluar që të ndërtonte një shtëpi të re për të na e ndryshuar sadopak jetesën. Por kjo gjë ishte shumë e vështirë për të, pasi jo vetëm që nuk kishim para, por në fshatin tonë nuk gjendeshin fare materiale ndërtime. Kështu babai kur kthehej nga Hoti ku punonte në Bonifikim, sillte gjithmonë me vete një thes me rërë që e mbante në kurriz gjithë rrugën. Pasi e linte thesin, para se të flinte shkante e punonte edhe dy orë të tjera duke thyer gurë që na duheshin për shtëpinë e re. Po kështu edhe nëna nga ana tjetër, robtohej akoma e më shumë. Ajo zgjohej që me natë dhe pasi gatuante diçka për ne dhe për babain, shkante në punë në kooperativë, nga ku kthehej vetëm në darkë me një barrë dru në shpinë. Ajo kurrë nuk kishte kohë për të pushuar, pasi lante rrobat tona, punonte në atë pak kopsht personal që kishim dhe ndihmonte babain në ndërtimin e shtëpisë së re. Megjithatë, ata bënë gjithë ato punë sfillitëse dhe mbyetëse, ne shpesh herë na mungonin lekët për të blerë bukë. Kështu mbaj mend që njeriu, i cili binte bukën të ngarkuar në kosha mbi mushka e gomarë, sa herë thërriste me të madhe: "Oooo Nik Marinaj, nëse i ke lekët hajde e merre bukën". Ai zë shpesh herë më tingëllonte i keq, sepse jo rrallë na mungonin lekët dhe ato mushka të ngarkuara prinin më kot nga ne shtatë fëmijët që flinim pa ngrënë darkë. Në vazhdim të përpjekjeve të tyre për të na



"KUAJT"

*Tërë jetën duke vrapuar rrimë
Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim,
Heshtim,
Dëgjojmë,
Hamë atë ç'na japin,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendjehollë.
Kush qe kalë mbreti,
Posti qe i lartë
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë
Kush qe kalë fshatari
Pat samarë me kashtë
Kush qe kalë i egër
Tërë natën fjeti jashtë.
Po qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!*

e rregulluar disi jetesën, prindërit vendosën dhe u shpërngulën për në fshatin Bajzë. Por edhe aty ku shkua, jetesa jonë nuk pati asnjë ndryshim nga Brruti ku jetonim më parë", përfundon Gjeka rrëfimin e tij me nota rëndëshe për gjendjen në të cilën ndodhej familja e tij deri në fundin e viteve '80-të".

Pasioni për poezinë
Ndonëse jetonte në një gjendje të mjeruar, Gjeka kishte një pasion të jashtëzakonshëm për librat, ai lexonte shumë si letërsinë shqiptare dhe atë të huaj. Lidhur me këtë gjë ai kujton: "Shumë kohë para se të filloja të shkruaja poezi, kam filluar të lexoj letërsi, e kryesisht poezi. Ngaleximi i letërsisë dhe i poezisë në veçanti më lindi dëshira për ta kultivuar në gjininë e poezisë. Jo vetëm për të shkruar poezi, por edhe për ta lexuar atë, shpesh herë jam ndëshkuar si nga prindërit ashtu dhe nga shoqëria. Më kujtohet si sot kur në vitin 1981 pati dalë botimi i tretë i romanit të

Ismail Kadarese "Dimri i Madh" dhe unë i kërkoja lekë nënës që ta blija atë. Tamam në atë kohë babai im ishte shtruar në spital, dhe nëna nuk kishte lekë që të m'i jepte ta blija atë libër. Unë si i marrosur që isha pas Ismail Kadarese, dhe i vendosur për ta blerë atë libër, bëra një plan i cili do të më krijonte mundësinë ta mbyllja atë problem. Kështu fshehurazi nënës, hapa dyshkur në të cilin flija dhe nxora leshin e deleve të shprishur që ishte aty. Pas kësaj në vend të leshit, futa aty disa rroba të vjetra të vëllezërve e motrave të mija. Pas kësaj shkova në dyqanin e fshatit e shita leshin dhe me ato para që fitova munda që ta blej librin e Kadarese. Të nesërmen gjithë ditën unë e lexova librin në këmbë, pasi nuk mund të ulesha në karrige nga vrugat e thuprës që më kishte rehatuar nëna, pasi e kishite pikasur paudhësinë e tij. Njëherë tjetër kur nuk isha më shumë se 11 vjeç, kishte dalë në librarin libri i Ndoc Paqlekës "Njatjeta Diell". Në atë kohë

**Marinaj, poeti
kaloi telat me**



faqet e "Dritës" ku asokohe dhe shumë poetë të tjerë e kishin ëndërr një gjë të tillë? Lidhur me këtë, shkrimtari Nasi Lera kujton. Gjekën e kam njohur aty nga pranvera e vitit 1990, kur vinte tek redaksia e gazetës "Drita" për të botuar ndonjë poezi. Ai ishte një djalë mjaft i edukuar dhe tepër i talentuar në poezi. Kur po pinim një kafe tek klubi i Lidhjes Shkrimtarëve, Gjeka më dha një cikël me poezi që t'ia shikoja. Pas pak na erdhi në tavolinë dhe Ndoc Gjetja të cilin pasi e prezantova me Gjekën, i thashë që t'i botonte një cikël, duke i bërë dhe një paraqitje të shkurtër, meqenëse ishte autori i ri e botonte për herë të parë. Ashtu siç biseduam, Ndoci i botoi Gjekës një nga ato poezi që atij i kishte pëlqyer më shumë, e cila titullohej "Kuajt". Nuk e mbaj mend mirë të hënën apo të martën, sapo shkova në zyrë më morën në telefon nga Komiteti i Partisë i Tiranës dhe më thanë se çfarë ishte ajo poezi që kishim botuar në gazetë e kush ishte autori i saj. Unë ju përgjigja se ai ishte një djalë i ri nga Kopliku dhe shumë i talentuar e meqenëse punonte në fshat me kuaj, ishte shumë i dashuruar pas tyre dhe iu kishte kushtuar një poezi. Nga ana tjetër e telefonit më thanë se ajo gjë nuk ishte ashtu siç po jua shpjego-

ja unë, sepse nga Shkodra ku ishte bërë problem i madh, ishte interpretuar ndryshe. Ata kishin telefonuar dhe ju kishin thënë se ai me kuajt personifikonte turmat e njerëzve. Unë iu përgjigja se për atë poezi, ai ishte mendimi im. Nuk e di se çfarë ndodhi më pas me Gjekën, por mora vesh se ai kishte pasur probleme në Shkodër, ku ajo poezi kishte bërë bujë të madhe dhe ai ishte detyruar të arratisë nga Shqipëria".

Gjeka: Pse u arratisa?
Botimi i poezisë "Kuajt", pati një jehonë mjaft të madhe sepse në ato pak rreshta aludohej hapur kundër sistemit totalitar komunist. Lidhur me këtë gjë, Gjeka kujton: "Disa ditë pas botimit të poezisë, më 11 shtator 1990, më erdhi një letër nga Dega e Brendshme e Shkodrës, ku njoftohesha të paraqitesha aty të nesërmen më datë 12, në ora 8:00. E kisha krejt të qartë se pse më kërkonin në Dega dhe vendosa që të arratisesha nga Shqipëria, duke ja mbathur kufirit për në Jugosllavi e më pas drejt Amerikës. Mendimin për t'u arratisur, unë e kisha pasur që përpara, aty nga viti 1989, (për t'u përgatitur zbrisja çdo ditë në Shkodër duke bërë stërvitje me ekipin e atletikës së Vllaznisë) por ajo letër e Degës së Brendshme ma shpejtoi atë. Për vendimin që mora, bisedova vetëm me kushëririn tim Tonin Marinaj, të cilin më së shumti e kisha shok të

i k a nga shkolla dhe shkova tek një fshatar për t'i kërkuar një litër raki, se gjoja më kishte dërguar mësuesi i matematikës. Pasi e mora rakinë, me pretekstin se nëna ime kishte nevojë për disa lekë, e shita tek një fshatar tjetër dhe kështu munda që të siguroj lekët për librin. Për mua poezia është gjinia më superiore e artit. Vetëm në poezi mund të gesh një përbërje të përbashkët gjeniale të arteve në një trup e shpirt të vetëm poetik: muzikalitetin imagjinues të një kompozitori, imazhin mediativ të një piktori, prozën e kondensuar të një romancierit, dramën vibruese të një dramaturgu e medikamentin shpirtëror të një lexuesi. Në një farë mënyre unë jetoj për të lexuar e krijuar poezi".

Nasi Lera : Ja si i botuam "Kuajt"
Deri në fundin e viteve '80, me një tufë poezish në xhep, Gjek Marinaj vinte shpesh në Tiranë për t'u takuar me mikun e tij, shkrimtarin Rudolf Marku. I cili duke parë talentin që kishte Gjeka, mundahej që t'i botonte ndonjë cikël poetik. Po si arriti që të botohej ajo poezi në

që në 1990-ën gjemba me "Kuajt"

3

firit, mendova se po të vritesha, të nesërmen do takoja Migjenin, Mjedën e ndoshta Pablo Nerudën. Po të më kapnin do të thoshte se do të gjendesha në Degën e Brendshme pak para orës 8:00 të mëngjesit të 12 shtatorit që më kishin caktuar ata. Kur kapërceva telat e klonit e u largova disa hapa, kam dëgjuar breshëri të shumta armësh të ushtarëve të kufirit, të cilët si duket kishin parë batanijen time mbi telat e klonit. Pasi kalova zonën kufitare, u nisa në drejtim të qytetit të Titogradit, ku më mbajtën 15 ditë në burg për shkelje kufiri. Më pas më dërguan në Beograd, ku kishte shumë shqiptarë të tjerë dhe midis tyre shumë intelektualë, që ishin arratisur nga Shqipëria e prisnin aty për të marrë azilin politik drejt Perëndimit. Në SHBA-ës kam mbërritur më 16 shtator të 1991-it. Kur mora statusin e azilantit politik në Beograd, pak para nisjes, ambasadori amerikan më pyeti: A ke prova që je kundër komunizmit? Në çast përkthyesi i lexoi poezinë time "Kuajt". Pas asaj, fjalët e para dhe të fundit që ambasadori amerikan nxori nga goja, ishin: Paç fat në Amerikë, bir".

Sukseset e Marinajt në SHBA


Që prej vitit 1991 kur Gjeka arriti në SHBA, ka punuar fillimisht shpesh në një dyqan e më pas ka

mbaruar Institutin Mjekësor ASPT. Në vitin 1994 është punësuar si Phelibatomist pranë Baylor Medical Center dhe në pranverën e atij viti ka mbaruar Kolegjin BROOKHAVEN për Shkencat e përgjithshme. Në vitin 2001, Gjeka u diplomua me rezultate të larta në Universitetin e UTD, për Artet dhe Letërsinë Botërore, me nëndegë gazetarinë. (Dy vjet më vonë ai mbrojti dhe masterin). Më 26 nëntor 1999, në një konkurs ndërkombëtar të poezisë që organizohet çdo vit nga universitetet amerikane, ai fitoi çmimin "Pena e Artë". Gjeka ka shkruar disa libra e vazhdon të shkruaj përsëri kryesisht poezi. Ai është botuar gjithashtu në vitin 1998 dhe në Antologjinë "BEST POEMS", ku përfshihen poezitë më të mira të viteve 90-të. Gjeka Marinaj është botues i gazetës "KOHA E POETËVE" (shqip-anglisht) dhe ka hapur Shtëpinë Botuese "MARINAJ PUBLISHING" ku kanë botuar librat e tyre disa nga penat e njohura të diasporës shqiptare në SHBA.

1. Gjeka Marinaj në Teksas të SHBA në 1995
2. Poezia "Kuajt" e botuar në gazetën "Drita" në gusht 1990
3. Ushtarë të kufirit gjatë një patrullimi në vitet '60-të. (foto ilustrative)
4. Ish-Prezidenti amerikan Xhorxh Bush të cilin Marinaj e intervistoi në 2001
5. Kopertina e një prej librave me poezi të Marinajt e botuar në SHBA-ës
6. Gjeka me tre shokë të fëmijërisë (Tonin Marinaj, Ago Ymeri dhe Ylli Sterkaj) në Kalanë e Rozafatit në vizitën e tij të parë në Shqipëri në 1994
7. Gjeka në shtëpinë e tij në Teksas, me kushërinin, Tonin Marinaj
8. Gjeka me Toninin gjatë një vizite në një prej atelieeve të Hollivudit

intervista

Presidenti u ndal edhe në marrëdhëniet e SHBA-së me Shqipërinë para viteve '90




Në vitin 2000 Gjeka intervistoi ish-Presidentin Bush

Përveç pasionit tij të hershëm Letërisë, gjatë periudhës së qëndrimit në SHBA-ës, Gjeka Marinaj është marrë dhe vazhdon të merret edhe me gazetari. Aty nga viti 2000, ai arriti të intervistonte ish-Presidentin e SHBA, Xhorxh Bush, intervistë të cilën Gjeka e botoi në gazetën "KOHA E POETËVE" (shqip-anglisht) që drejtohej dhe vazhdon ta drejtojë vetë. Në atë intervistë të gjatë midis të tjerash presidenti amerikan, u shpreh: "Për shumë vite, as ne amerikanët nuk kemi pasur fare marrëdhënie me Shqipërinë. Shqipëria ka qenë në vëmendjen tonë pothuajse fundit nga të gjitha shtetet e botës. Edhe ish-Bashkimi Sovjetik edhe Kina, kanë qenë shumë më të butë me Perëndimin se sa Shqipëria. Ai vend nën Enver Hoxhën akoma jetonte epoka të errëta. Kur lufta e ftohtë midis nesh dhe Rusisë përfundoi, ne u munduam që t'i jepnim ndihmën tonë Shqipërisë, ashtu siç duhet të bënim". Pas raporteve të SHBA-

ve me Shqipërinë komuniste para viteve '90-të, ish-Presidenti amerikan Xhorxh Bush iu përgjigj gazetarit Marinaj edhe për problemin e Kosovës. Lidhur me këtë midis të tjerash ai u shpreh: "Unë kam qenë dy herë në Shqipëri. Ne bëmë mirë në përpjekjen tonë për ta hapur sado pak atë vend, kur udhëheqja shqiptare e pati dëshirën. Por ne nuk kemi ndonjë farë obligimi të garantojmë paqe në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Këto dy vende kanë histori të lashta dhe të pasur konfliktesh. Nga ana tjetër unë nuk e prisja, që Millosheviçi të vazhdonte një aktivitet të tillë kundër kosovarëve. Po në të njëjtën kohë mbetem me bindjen se roli i Amerikës në këto dy vende duhet të jetë thjesht rol negociator".


5



6



8



DESHMIA E SHKRIMTARIT TE NJOHUR QE INKURAJOI DJALOSHIN REBEL NE 1990-EN

Rudolf Marku : Atë poezi do ta dëshironte kushdo

Një nga njerëzit që e pati afruar Gjeken në ambientet e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe e inkurajoi në rrugën e poezisë, ka qenë edhe ish-deputeti, shkrimtari, poeti, publicisti dhe përkthyesi i njohur, Rudolf Marku, i cili prej vitesh jeton e punon në Londër. Në lidhje me poezinë e famshme "Kuajt" dhe vetë Gjeken, ai shprehet: "Fati e desh që Gjeka Marinaj të bëhej i njohur vetëm me atë poezi të botuar në një cep të gazetës "Drita", shumë e shumë më tepër nga autorët voluminozë, të cilët kishin vite

mbytëse, absurde, fyese, groteske. Në Shkodër trupat e të vrarëve në kufi i tërhiqnin zvarrë përpara syve të shqyer të njerëzve. Turmat rrinin në radhë me shpresë se mund të blihej një shishe qumësht. Nëpër trena, gjatë udhëtimit, njerëzit shkullnin dërrasat e dyshemesë e ndzinin zjarre. Çdo gjë dukej se ishte kundër letërsisë e poezisë. Të zënë me preokupimet më banale të jetës, dukej se kujtimi i poezisë, i fantazisë, i ndjenjave, i fyente njerëzit. Çuditërisht në këtë atmosferë aq të kobët, njerëzit thërrisnin në ndihmë poezinë. E vetmja radhë që nuk

të titulluar "Kuajt" dhe emri i autorit quhej Gjeka Marinaj. Poezia pati një jehonë të jashtëzakonshme. Nëpër trenat e djegur ku kishin mbetur vetëm skeletet metalike njerëzit nxirrnin nga xhepi një letër të zhubrosur ku ishte kopjuar poezia "Kuajt". Ajo ishte një poezi e shtruar në mënyrën më naive, me një shkujdesje ritmike dhe e paorganizuar deri në fund. E me gjithë atë fatin e saj do ta kishin dëshiruar edhe poezitë më të qëndrueshme antologjike. Poezia "Kuajt" i krijoi telashe të papritura autorit njëzetvjeçar. Dikush më tha se Gjeken e